



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**  
**Shoqëria Përmbareuese "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK**  
NIPT L22412014N  
Licencë LN-5977-12-2012

Nr. 241/3 Prot.  
Nr. 241 Regj.

Datë 28.03.2019

**URDHËR**  
**PËR VËNIEN E SEKUESTROS**

- Drejtuar:** Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), me adresë Bulevardi Zhan D'Ark, Prona nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë.
- Për dijeni Kreditorit:** Shoqëria "ALB - ADRIATIK" SHA, shoqëri tregtare e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT K58515503O, me zyrë qendrore në Shëngjin, Lezhë.
- Për dijeni Debitorit:** Shoqëria "NOA Development" SHPK, shoqëri tregtare e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L42203032I, me zyrë qendrore në rruga "Nikolla Tupe", ndërtesa nr. 4, kati 1, Tiranë.

Pranë shoqërisë përmbareuese "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK, sipas kërkesës datë 15.03.2019, të kreditorit "ALB - ADRIATIK" SHA, është regjistruar çështja përmbareuese me nr. 241 Regj, datë 15.03.2019 me palë:

- Kreditor:** "ALB - ADRIATIK" SHA  
**Debitor:** "NOA Development" SHPK  
**Objekti:** Vënie në ekzekutim të titullit ekzekutiv faturë tatimore të shitjes nr. 17, datë 30.10.2018, nr. serie 39516668, për të cilin është dhënë vendimi nr. Regj. Them. 879, datë 01.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë "Për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit".

Unë përmbareuese gjyqësore private Fatjona Duka, pasi u njoha me dokumentacionin e ndodhur në dosjen përmbareuese,

**KONSTATOVA**

Se midis kreditorit "ALB - ADRIATIK" SHA dhe debitorit "NOA Development" SHPK ka pasur një marrëdhënie nënkontraktimi, sipas të cilës kreditori ka kryer punimet për zgjerimin e rrjetit TM 20KV në Elbasan, etj. Për punimet e kryera kreditori dhe ka lëshuar edhe faturën tatimore të shitjes nr. 17, datë 30.10.2018, nr. serie 39516668. Kjo faturë është likuiduar pjesërisht nga ana e debitorit dhe kreditori i është drejtuar gjykatës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, për pjesën e pashlyer të detyrimit, si dhe pagimin e kamatëvonesave, për pagesë me vonesë të detyrimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dhënë vendimi nr. Regj. Them. 879, datë 01.03.2019, "Për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit", me të cilin ka vendosur:

- "- Pranimin e kërkesës së kërkuesit Shoqëria "Alb-Adriatik" sha.*  
*- Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për faturën tatimore të shitjes nr. 17, datë 30.10.2018, nr. serie 39516668, duke u paguar detyrimi i mbetur në shumën 50.000.000 (pesëdhjetë milion) lekë, me shitës: Shoqëria "Alb-Adriatik" sha, me NIPT K58515503O dhe blerës: Shoqëria "Noa Development" shpk, me NIPT L41806010J, si dhe mbi këtë detyrim të përllogariten nga përmbareuesi gjyqësor në fazën e ekzekutimit, kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht sipas nenit 5 të*

*Ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare".*

Me anë të kërkesës drejtuar shoqërisë përmbarese "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK, kreditori "ALB - ADRIATIK" SHA ka kërkuar vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv faturat tatimore të shitjes, duke u paguar detyrimin i mbetur në shumën 50,000,000 (pesëdhjetë milion) lekë, së bashku me kamatëvonesat ligjore për pagesë me vonesë të këtij detyrimi.

Kreditore "ALB - ADRIATIK" SHA i ka kërkuar përmbaresit gjyqësor, që në bazë të nenit 519 të Kodit të Procedurës Civile, të fillohen menjëherë procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm pasi ka bindjen e plotë se me kalimin e afatit, ekzekutimi do të bëhet i pamundshëm, duke qenë se kreditore i është drejtuar disa herë debitorit për shlyerjen e detyrimit, por prej tij nuk është ekzekutuar pagesa. Sipas informacionit të kreditorit debitor "NOA Development" SHPK, është paguar nga OSHEE, në cilësinë e kontraktorit kryesor, për punimet që janë kryer nga nënkontraktore shoqëria "ALB-ADRIATIK" SHA dhe ka shmangur pagimin e detyrimit ndaj kreditorit.

Në këto kushte në bazë të nenit 519, 527 të K.Pr.Civile, vendosa të filloj procedurat për ekzekutimin e detyrueshëm të titullin ekzekutiv faturë tatimore shitje nr. 17, datë 30.10.2018, nr. serie 39516668, për të cilin është dhënë vendimi nr. Regj. Them. 879, datë 01.03.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, "Për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit".

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të neneve 527 e vijues të Kodit të Procedurës Civile; Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat";

### **URDHËROJ**

- 1 Vënien e sekuestros në aktivet e palës debitore shoqëria "NOA Development" SHPK, shoqëri tregtare e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L42203032I, në këtë fazë të ekzekutimit, në shumën prej 52,400,000 (pesëdhjetë e dy milion e katërqind mijë) lekë.
2. Vënien e sekuestros në kuotat ose aksionet që debitor shoqëria "NOA Development" SHPK, shoqëri tregtare e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L42203032I, mund të zotërojë në shoqëri të tjera, në cilësinë e ortakut ose aksionarit.
3. Për veprimet ose mosveprimet tuaja, na informoni me shkresë, brenda afatit ligjor.
4. Ndaj personave që do të pengojnë zbatimin e këtij titulli ekzekutiv në kundërshtim me parashikimet e ligjit, përmbaresi gjyqësor ka të drejtë të aplikojë sanksionet e parashikuara në nenet 598 dhe 606 të Kodit të Procedurës Civile si dhe të ndër marrë çdo sanksion tjetër të parashikuar nga ligji.
5. Ky urdhrë i njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile kanë të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij.

**Shoqëria "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK  
Përmbaresi Gjyqësor Privat  
Fatjona Duka**